

E-buletini no. 20 | Janar - Dhjetor, 2020



10

**vjetori i themelimit
të Rrjetit për
Zhvillim Rural**





10 VITE REZULTATE TË RRJETIT PËR ZHVILLIM RURAL TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

15 PROJEKTE TË ZBATUARA

të mbështetur nga donatorë të ndryshëm (USAID, BE, We Effect, GIZ, UNDP, FAO, GEF, Cívica Mobilitas)



85 ORGANIZATA ANËTARE



PROMOVUES I PARË I QASJES LEADER

- 5 GLA të themeluar që përfshijnë 21 komuna
- Kapacitete të ngritura të aktorëve relevant në lidhje me zbatimin e LEADER qasjes së BE-së



59 NËN-PROJEKTE ME GRANTE, TË ZBATUAR NGA OJQ-TË LOKALE DHE GLA-TË LOKALE

PARLAMENTI I PARË RURAL KOMBËTAR NË MAQEDONINË E VERIUT!

NGRITJA E KAPACITETEVE TË ANËTARËVE TË RZR-SË DHE ORGANIZATAVE THEMELUESE (GRASS-ROOT)

me anë të trajnimeve për: përpilimi i propozimeve për projekt; drejtimi me projekte; drejtimi financiar; shkathtësitë e komunikimit; barazia gjinore; koncepti i ekonomisë së gjelbër; kërkimi dhe analiza; rrjetëzimi; përfaqësimi dhe lobimi.



2 KARAVANË TË EKONOMISË SË GJELBËR

prezantimi i sipërmarrësve të gjelbër në vend



MASAT ADAPTIVE TË NDRYSHIMIT KLIMATIK TË PROMOVUAR NË BUJQËSI

28 demonstrime të mënyrave dhe formave në kopshte, hardhi, perime, humbje të dheut, kursim i ujit, dhe bagëti



KARAVANI PËR NDRYSHIMIN KLIMATIK

10 ndalesa në rajonet rurale të gjithë territorit



ZRR I MV ËSHTË ANËTAR AKTIV I PËRPARË, ELARD DHE ANËTAR THEMELUES I RBZR



TABELA E PËRMBAJTJEVE

10 vjetori i themelimit të Rrjetit për Zhvillim Rural	4
Shënohet Dita Ndërkombëtare e Gruas nga Rrethina Rurale	6
Kremtim i Ditës Ndërkombëtare të Grave Rurale në Vendet Ballkanike	9
Sub-granting.....	11
Trajnime dhe takime në internet të organizuara nga RZR përgjatë vitit 2020	15
Rrethi i Studimit të Mjedisit	16
Sigurimi me ushqim dhe përforcimi ekonomik i komuniteteve më të cenuar në Maqedoninë e Veriut	17
Strategjitë e Zhvillimit Lokal të Rishikuara	20
Garë për storie gazetareske	21
Një vizion për Evropë Rurale	22
Zhvillimi rural me anë të Aerodromit Sportiv	23
ZËRI I LUMIT TË BARDHË Kolonia Artistike 2020	25
Projekt IPA i BE: ZBULIMI I ATRAKSIONEVE TË FSHEHURA	25
Tradita dhe artizanet e vjetra si pasuri e madhe kombëtare	27
Oferta e integruar dhe informative e territorit të GLA Bojmija	28
Zgjidh shëndetshëm – bli produkte lokale	29
SHQ CeProSARD në organizimin për shënimin e Ditës Ndërkombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuar	30
Programi për trajnim të shërbimit të turistëve	32
Teknologji referuese për efikasitet energjetik dhe burime të ripërtëritë të energjisë me vlerësim të konsumit energjetik të spitaleve dhe punëtori në temën "Spitale me energji afër zeros"	33
Viti 2020 – 14 vite nga ekzistimi i Qendrës Rajonale për Përfaqësim – Dellçevë	34
Koalicioni Rural	36



10 vjetori i themelimit të Rrjetit për Zhvillim Rural

Në vitin 2020, Rrjeti për Zhvillim Rural i Maqedonisë së Veriut ka festuar 10 vjetorin e themelimit. Një numër i projekteve të zbatuara me sukses, kapacitete të rritura të organizatave anëtare dhe krijimi i partneriteteve të shumta për bashkëpunim të përbashkët në përmirësimin e kushteve të jetesës së mjediseve rurale, janë vetëm një pjesë e rezultateve të cilat Rrjeti për Zhvillim Rural i ka arritur gjatë punës së saj 10 vjeçare.





Rezultatet e arritura dhe aktivitetet e zbatuara ishin prezantuar në Kuvendin Vjetor të RZR që ishte mbajtur më 10 shtator, në Strugë. Ngjarja ishte organizuar në përputhje me masat e përcaktuara parandaluese për mbrojtje nga COVID19, në prani të përfaqësuesve të 21 anëtare aktive të RZR, ndërsa 6 anëtare tjera e kanë ndjekur Kuvendin me anë të internetit. Në kudër të Kuvendit Vjetor ishte zbatuar një votim për zgjedhjen e kryetarit të Rrjetit për Zhvillim Rural, në të cilën të pranishmit ishin njëzëri për ri-zgjedhjen e kryetarit aktual, Petar Gjorgievski, me çfarë kishte marrë një mandat të ri prej 4 viteve.

Kuvendi ka përmbyllur 10 vjetorin e punës

së RZR me diskutim të frytshëm mes anëtarëve, ndarje të përvojave dhe njohuri lidhur me zhvillimin rural të vendit, por edhe shkëmbim të ideve të aktiviteteve të mëtutjeshme dhe bashkëpunim në kuadër të Rrjetit për Zhvillim Rural. Në fund, Petar Gjorgievski i ftoi anëtarët në mënyrë aktive të kyçen në aktivitetet e ardhshme të RZR, të cilat do të përqendrohen në përforcimin e kapaciteteve të Rrjetit, dhe anëtarët, si dhe LEADER, si qasje inovative në kuadër të politikës për zhvillim rural të BE për stimulimin e barazisë dhe unitetit për gjithë palët e interesuara në proceset e ndërtimit të politikave, miratimit të vendimeve dhe zbatimit të aktiviteteve lidhur me zhvillimin rural.

Shënohet Dita Ndërkombëtare e Gruas nga Rrethina Rurale




Këtë vit ishte organizuar një takim në Zoom me rastin e 15 tetorit – Dita Ndërkombëtare e Gruas nga Rrethina Rurale, ditë që tradicionalisht kremtohet me ngjarje festive të organizuar nga ana e Federatës Kombëtare të Fermerëve, Rrjetit për Zhvillim Rural dhe Organizatës Suedeze për Zhvillim We Effect. Në këtë takim kanë marrë pjesë rreth 100 gra nga rrethinat rurale, përfaqësues të institucioneve shkencore, arsimore, publike dhe tjera të cilët bashkëpunojnë me popullatën rurale.

Këtë vit, Dita Ndërkombëtare e Gruas Rurale ishte shënuar me diskutim lidhur me temën aktuale të krizës me koronën, por në kuptim të gruas rurale dhe problemet dhe sfidat me të cilat përballohet. Gratë në rrethinat rurale vetëm më herët përballoheshin me probleme specifike në jetën e tyre të përditshme, të cilat, bashkë me krizën me koronën, ishte bërë më të theksuara. Një pjesë e problemeve me të cilat përballohen këto gra gjatë situatës aktuale janë ulja e

qasjes në shërbime cilësore shëndetësore, dukshmëria më e madhe e punës së papaguar, intensifikimi i dhunës së bazuar në gjini, dezinformacione dhe mungesë e qasjes në teknologji kritike për punën e tyre dhe jetën private. Disa prej këtyre problemeve ishin zbuluar me anë të Analizës së Grave Rurale dhe Kriza me Koronën që ishte hartuar nga Federata Kombëtare e Fermerëve – FKF, që ishte prezantuar edhe gjatë ngjarjes.

“Efektet negative të pandemisë me koronën ndikojnë mbi gratë në rrethinat rurale. Analiza e FKF për bujqësi dhe krizës me koronën, që është mbështetur nga We Effect ka treguar që tek 85% e grave në mjediset rurale është rritur puna në fushë dhe në shtëpi. 64% e grave rurale nuk janë aktive në tregun e punës për shkak të angazhimeve në amvisëri dhe kujdesin e fëmijëve, ndërsa 47% e grave të papunë rurale kryejnë punë të papaguar në ferma familjare. Federata Kombëtare e Fermerëve kërkon realizimin



e masës 115 për anëtarë aktiv femëror në ekonominë bujqësore nga Programi për Mbështetje Financiar të Zhvillimit Rural 2019, si dhe krijimin e masave dhe politikave të cilat do të jenë pjesë e Strategjisë së Re për Bujqësi dhe Zhvillim Rural me theks të veçantë në përmirësimin e pozitës ekonomike dhe sociale të grave në rrethinat rurale”, theksoi Vaska Mojsoska, kryetare e Federatës Kombëtare të Fermerëve.

Në takimin në Zoom fjalime të tyre kanë pasur edhe Jagoda Shahpaska, Ministre e Punës dhe Politikës Sociale, Trajan Dimkovski, Zëvendës Ministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujit, kristin Forsgren Bengston, Ambasadore e Mbretërisë së Suedisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Aneli Leina, drejtore rajonale e Organizatës Suedeze për Zhvillim We Effect dhe Petar Gjorgievski, kryetar i Rrjetit për Zhvillim Rural.

“Gruaja nga rrethina rurale është një fuqi punëtore e padukshme dhe vuan nga lloje të ndryshme të diskriminimit. Mundi i tyre nuk paguhet, kanë qasje të kufizuara në burime të financimit dhe nuk janë të përfshirë në procesin e vendimmarrjes. Në

kushte të kësaj krize, gjithnjë e më tepër është rritur rreziku për gruan nga rrethina rurale. Ne dëshirojmë që të shohim avancim në këtë fushë. Të gjitha shtetet anëtare që kanë pranuar Konventën e OKB-së për Eliminimin e Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, siç është edhe Republika e Maqedonisë së Veriut, duhet të respektojnë këtë konventë me qëllim që edhe gruaja nga rrethina rurale të merr pozitën që e meriton”, deklaroi kristin Forsgren Bengston, ambasadore e Mbretërisë së Suedisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

“Gratë rurale të cilat tradicionalisht e ushqejnë familjen dhe kujdesen për mirëqenien luajnë rol të rëndësishëm në sigurimin e amvisërive me ushqim. Ata gjithashtu janë edhe themeli i ekonomisë rurale duke punuar si fermerë, punëtorë sezonal por edhe sipërmarrës rural. Projektet e mbështetur nga We Effect në Maqedoninë e Veriut tregojnë që investimi në gratë rurale mund të krijojë një përmirësim të dukshëm të prodhimit, sigurimit me ushqim dhe zhvillim të qëndrueshëm rural. Bashkësitë rurale kanë dobi të madhe ekonomike dhe sociale kur gratë kanë qasje në arsim, trajnime,



dhe shërbime financiare dhe organizata të fuqishme. Prandaj, mbyllja e nyjës gjinore në bujqësinë nuk është vetëm çështje e grave, por është një çështje e familjes, bashkësisë dhe gjithë shoqërisë”, theksoi Aneli Leina, drejtore rajonale e Organizatës Suedeze për Zhvillim We Effect.

Jagoda Shahpaska, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale theksoi që Ligji për Mbrojtje dhe Parandalim të Diskriminimit është në procedurë të miratimit dhe theksoi një shtesë që prej 300 marrëveshjeve të lidhura për marrje me qira të tokës bujqësore, vetëm 76 marrëveshje janë lidhur me gra fermerë.

“Duhet të tejkalohen stereotipat tradicionale, të hapen çerdhe dhe shtëpi të pleqve, në mjediset rurale për të ndihmuar grave të mund të kyçen në tregun e punës”, thotë Shahpaska.

Duhet të ketë një përpjekje aktive e gjithë aktorëve të për prezantimin e masave përkatëse për zbutjen e bareve së kujdesit dhe shpërndarjen më të mirë mes burrave dhe grave, për gatishmërinë e shërbimeve për gratë në rrethinat rurale dhe mbështetje të prodhimtarisë dhe punës së papaguar shtëpiake. Gratë kanë rol kryesor në sigurimin e qëndrueshmërisë së amvisërive rurale dhe bashkësive, si dhe përmirësimin e mirëqenies së plotë, por që ky rol ende nuk është mjaft e njohur ende mund të vërehet nga dokumentari i shkurtër i FKF “Shtyllat e Padukshme të Fshatrave”. Nga ana tjetër, që gratë të jenë të inspiruar dhe të nxitur të punojnë në përf forcimin e shkathtësive

të tyre sipërmarrëse, në ngjarjen ishte ndarë një vide me shembuj pozitiv të grave sipërmarrëse nga rrethinat rurale në vend, të cilën ka përpiluar Rrejtja për Zhvillim Rural.

“Duhet të ndikojmë në mënyrë nxitëse mbi gratë rurale, me anë të prezantimit të praktikave të mira dhe historive të suksesshme për gra sipërmarrëse në mjediset rurale, të cilat do të ishin inspirime për gratë tjera dhe dëshmi që ata janë të fuqishëm të lirohen nga pengesat tradicionale, të aftësuar për të ndryshuar shprehitë dhe për të larguar stereotipat. Përforcimi i grave rurale është e rëndësishme edhe në kuptim të prosperitetit global, për arritjen e objektivave të mileniumit dhe sigurimin e shoqërisë së sigurt dhe të qëndrueshme. Prandaj ne si organizata i vendosim gratë rurale në zemrën e programeve zhvillimore”, theksoi Petar Gjorgievski, kryetar i Rrejtjes për Zhvillim Rural i RM.

Trajan Dimkovski, zëvendës ministër i bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujit theksoi që në Regjistrin Unik për Ekonomi Bujqësore prej gjithsej 171 000 fermerë të regjistruar, janë regjistruar 37 186 gra, gjegjësisht 21.7% të numrit të plotë.

Takimi vjetor me rastin e 15 tetorit, ka nxitur një diskutim të frytshëm mes pjesëmarrësve, shumë përvoja dhe informacione të ndara dhe ishte përmbyllur me konkluzione të pasura dhe drejtime për punën e ardhshme në përmirësimin e gjendjes së grave në rrethinat rurale dhe rritje të barazisë gjinore.



Kremtim i Ditës Ndërkombëtare të Grave Rurale në Vendet Ballkanike

Për të njohur "rolin kritik dhe kontributin e grave rurale, përfshirë edhe gratë autoktone, në përf forcimin e zhvillimit bujqësor dhe rural, përmirësimin e sigurisë së ushqimit dhe çrrënjësjes së varfërisë", 15 tetori në botë kremtohet si Dita Ndërkombëtare e Gruas Rurale. Duke ndjekur praktikën e mirë të Rrjetit për Zhvillim Rural të Maqedonisë së Veriut, që çdo vit, në mënyrë tradicionale, organizon ngjarje dhe mbledh gjithë aktorët relevant të gjithë vendit me rastin e 15 tetorit, partnerët e Rrjetit Ballkanik për Zhvillim Rural, Rrjetet për Zhvillim Rural të Malit të Zi dhe Serbi, këtë vit kanë nisur kremtimin e Ditës Ndërkombëtare të Gruas Rurale në vendet e tyre.

Duke marrë gjitha masat e kujdesit për shkak të zhvillimeve të fundit me pandeminë, rrjetet kanë organizuar 2 ngjarje të vogla me rreth 30 pjesëmarrës në Nikshiq, Mal të Zi dhe Vrnjačka Banja, Serbi.

Kryetari i Rrjetit për Zhvillim Rural të Serbisë, Dragan Roganović, i cili edhe hapi ngjarjen, theksoi rolin e rëndësishëm të grave në zhvillimin e ekonomisë rurale dhe ekzistencës rurale në përgjithësi. Ai theksoi që vetëm aktivitetet që i koordinojnë gjithë palët e interesuara, duke filluar nga vendimmarrësit, pushtetet lokale, shoqatat dhe sektori afarist dhe vetë gratë, mund të krijojnë parakushte të mira për përmirësim



të pozitës së grave rurale. Gjatë ngjarjes ishin prezantuar shembuj të shkëlqyeshëm për sipërmarrje të grave në rrethinat rurale, siç është gruaja rurale që ka filluar biznes familjar për turizëm rural dhegruaja rurale që prodhon ushqim tradicional.

Rrjeti për Zhvillim Rural i Malit të Zi dhe organizata, Shoqata e Vreshtarëve "Boka" kanë mbledhur më tepër se 30 pjesëmarrës me rastin e 15 tetorit, duke pritur që kjo mbledhje të rritet në kremtim tradicional gjatë viteve në vijim. Ratko Bataković, kryetar i Rrjetit për Zhvillim Rural i Malit të Zi në fjalimin përshëndetës ka theksuar rolin kryesor që gratë e luajnë në sigurimin e qëndrueshmërisë së amvisërive rurale dhe bashkësive, përmirësim të mjediseve rurale për ekzistencë dhe mirëqenien e plotë, role që gjithë e më tepër njihen. Pjesëmarrësit e ngjarjes gjithashtu kanë pasur mundësi që të vizitojnë një grua rurale sipërmarrëse në fshatin e vogël Brno, afër Nikshiqit, dhe të dëgjojnë historinë e saj për fillimin e biznesit të vogël, një fabrikë të vogël "Kornelian" për prodhimin e lëngjeve dhe produkteve tjera të qershisë. Ngjarja në Mal të Zi ishte plotësuar edhe me kyçje të Maqedonisë së Veriut, që ishte lidhur me anë të Zoom platformës. Në këtë mënyrë, aktorët e mjediseve rurale në Mal të Zi kanë mundur të shohin se çfarë rëndësie të madhe japin Ditës Ndërkombëtare të Grave Rurale në Maqedoninë e Veriut dhe si ky kremtim ka kontribuar për ngritjen e zërit të grave rurale në vend. Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Grave Rurale në Maqedoninë e Veriut, si dhe në Serbi dhe Mal të Zi, ishte mbështetur



nga Organizata Suedeze për Zhvillim We Effect, si pjesë e aktiviteteve të zbatuar për përf forcim të kapaciteteve të Rrjetit Ballkanik për Zhvillim Rural.

Sub-granting

Për të përmirësuar punën e projekteve të RZR dhe për të rritur pjesëmarrjen e anëtarëve të RZR në aktivitete të përbashkëta nga fusha e zhvillimit rural, Rrjeti ka përgatitur një procedurë për punë me projekte në RZR. Kjo procedurë ka për qëllim për të arritur rezultatet/përmirësimet vijuese në punën e RZR:

- përforsim i kapacitetit të anëtarëve të RZR për punë në partneritet të përbashkët;
- rritje të njohurive dhe shkathtësive të anëtarëve të RZR për punë në iniciativë të përbashkët dhe mobilizim të resurseve lokale;
- zbatim i përmirësuar i RZR në pjesën e punës me projekte të bazuar në nevojat e bashkësive lokale që anëtarët e RZR janë përfaqësues;
- kapacitete të përforsuar të RZR për koordinim dhe realizim të iniciativave të brendshme.

RZR, në maj të vitit 2020, ka siguruar mbështetje të projektit "Ngritja e kapaciteteve të RZR dhe anëtarëve, të financuar nga We Effect, për zbatimin e 7 iniciativave të projektit të anëtarëve.

1. **Nën-grantist:** Shoqata "Qendra Edukative për Ruajtjen e Natyrës", f. Negrevë, Pehçevë

Titulli i projektit: Të zbulojmë natyrën

Qëllimi i projektit: Qëllimi i përgjithshëm i projektit është vendosja e bashkëpunimit me persona profesional të organizatave tjera, që ka për qëllim edukimin ekologjik dhe mbrojtje të mjedisit jetësor në shkëmbim të përvojave dhe praktikave për të arritur edukim i suksesshëm ekologjik të grupeve të synimit, që do të kontribuojë për relacion më të mirë me mjedisin jetësor.



Rezultate të arritura:

- kapacitete të përforsuara të punësuarve të Qendrës Edukative. Të aftësuar për të organizuar dhe zbatuar aktivitete edukative interaktive në natyrë.
- hartimi i manualit për zhvillimin e punësorive familjare në Qendrën Edukative, që përmban pako edukative me përmbajtje të krijuar për secilën stinë të vitit (pranverë, verë, vjeshtë dhe dimër).
- hartimi i dokumentit me drejtim dhe aktivitete që duhet të merren për afirmim më të gjerë të qendrës edukative, me anë të themelimit të bashkëpunimit me institucionet arsimore (çerdhjet, shkollat dhe fakultetet) si dhe mediat.
- shtypja e afishes me aktivitete që ofron Qendra Edukative për organizim të punësorive familjare.
- rritja e interesit për vizitë të Qendrës dhe zbatim të aktiviteteve edukative në natyrë nga familje të plotë.



2. **Nën-grantist:** Fondacioni për Zhvillim Lokal dhe Zhvillim të Teknologjive Informatike – (FLORIT) Gjevgjeli

Titulli i projektit: Zgjidh shëndetshëm – bli produkte lokale

Qëllimi i projektit: Qëllimi i përgjithshëm i projektit ishte të krijohen kushte për rritjen e të ardhurave të fermerëve të vegjël me anë të tërheqjes së fermerëve të rinj me anë të prezantimit të inovacioneve në bujqësi dhe zhvillim rural. Synimi i projektit është të prezantohet një metodë e re inovative ose model që i përfshin fermerët dhe palët tjera të interesuara për aktivitete të përbashkëta për të arritur një sistem të qëndrueshëm që është ndërtuar me anë të partneritet, që është një prej parimeve të qasjes LEADER për zhvillim rural.

Rezultate të arritura:

- Sistemi i vendosur i shitjes direkte të ushqimit të prodhuesve të vegjël tek konsumatorët,
- Ndërtimi i besimit të konsumatorit në vlerën e ushqimit të prodhuar në vend, duke përfshirë vërtetësinë dhe sigurinë e ushqimit,
- Rritja e konkurrencës së prodhuesve me prezantimit dhe përdorimit të teknologjive dhe inovacioneve më të fundit, si dhe njohurive të fituara në lidhje me përdorimin e tyre.

3. **Nën-grantist:** Koalicioni Rural

Partner: Shoqata e Fermerëve Gra “Moja farma”

Titulli i projektit: Barazia gjinore - çelësi për një bashkësi rurale ekonomisht të fortë

Qëllimi i projektit: Rritja e ndikimit të grave nga zonat rurale në proceset e krijimit dhe miratimit të politikave dhe vendimeve publike.

Ky qëllim korrespondon drejtpërdrejt me pjesën e misionit të shoqatës që synon të ndikojë në politikat kombëtare dhe lokale, në mënyrë që të arrihet një zhvillim rajonal i barazuar.

Rezultate të arritura:

- Hartimi i sfidave ekonomike me të cilat përballen gratë në zonat rurale, përfshirë pasojat e krizës së virusit korona;
- Rritja e ndërgjegjësimit dhe dukshmërisë së nyjës ekonomike gjinore në zonat rurale për publikun e gjerë;
- Rritja e njohurive dhe aftësive për përfaqësim për fuqizimin ekonomik të grave në zonat rurale.





4. **Nën-grantist:** Rrjeti i fermerëve të rinj – RFR, f. Mesheishte, Debarcë

Titulli i projektit: Rrjeti i qëndrueshëm i fermerëve të rinj për rivitalizimin e bujqësisë dhe zonave rurale

Qëllimi i projektit: Rrjeti i Fermerëve të Rinj (RFR) të njihet nga të rinjtë, si një përfaqësues i interesave të fermerëve të rinj dhe të rinjve në zonat rurale dhe një pjesëmarrës në procesin e përmirësimit të kushteve të fermerëve të rinj.

Rezultate të arritura:

- Zhvillimi i rregullores për punën e ekipit kombëtar, rregullore për komunikim të brendshëm, rregullore për anëtarësim;
- Përmirësimi i njohurive dhe aftësive të anëtarëve në fusha specifike për raportimin dhe mekanizmin e raportimit të brendshëm;
- Përmirësimi i njohurive dhe aftësive të anëtarëve për menaxhimin financiar në organizatë dhe raportimin financiar;
- Zhvillimi i një sistemi për informimin dhe komunikimin me anëtarët dhe publikun e gjerë përmes zhvillimit të një informatori në internet për aktivitetet vjetore të RFR-së dhe aktivitetet e planifikuara në të ardhmen;
- Zhvillimi i një sistemi informacioni dhe komunikimi me një faqe të azhurnuar dhe të përmirësuar të FRF-së të përkthyer në anglisht dhe shqip,

- Avancimi dhe përmirësimi i funksionimit të Rrjetit me procedurat e vëzhguara administrative dhe mbajtja e takimit vjetor.

5. **Nën-grantist:** Shoqata për zhvillim rural Grupi Lokal i Aksionit ABER 2015, f. Staro Nagoriçane

Titulli i projektit: Të avancojmë Sistemin ekzistues Energjetik në rajonin tonë

Qëllimi i projektit: Përmirësimi i Sistemit Ekzistues Energjit, promovim dhe zbatim i moduleve të reja të bazuara në Demokracinë Energjietike në mikro rajonin Likovë-Kumanovë-Staro Nagoriçane

Rezultate të arritura:

- Informim dhe edukim më i madh i OJQ-ve lokale dhe sektorit të biznesit përmes bashkëpunimit me organizata ndërkombëtare nga BE-ja për të përmirësuar sistemin ekzistues energjetik në rajonin verilindor.
- Propozime të zhvilluara për ndryshimin e Politikave ekzistuese Strategjike dhe Dokumenteve bazuar në prova (dokument i shkurtër i politikave publike - baza për aktivitetet e mëtejshme, d.m.th. përbërësi i qëndrueshmërisë së projektit).
- Procedura e nisur dhe zbatuar për harmonizim të personit/ave ekzistues juridik për përmirësim të sistemit ekzistues energjetik në mikro-rajon në përputhje me praktikat e BE-së.





6. **Nën-grantist:** Shoqata për zhvillim rural
Grupi Lokal i Aksionit MALESH-PIJENEC

Titulli i projektit: Malesh-Pijenec është
destinacioni juaj i ardhshëm

Qëllimi i projektit: Qëllimi i përgjithshëm
i projektit është të kontribuon për
përmirësimin e kushteve për jetesë në
bashkësitë lokale në territorin e GLA Malesh
Pijanec, dhe të përmirëson ekonominë lokale
nëpërmjet përdorimit të qëndrueshëm të
resurseve natyrore në promovimin e turizmit
rural.

Rezultate të arritura:

- Oferta të përgatitura turistike me qasje
të integruar që përfshin ofruesit vendorë
të shërbimeve
dhe produkteve, bazuar në kërkesat e
turistëve/operatorëve turistikë;
- Promovohen ofertat e krijuara turistike.

7. **Nën-grantist:** Shoqata për Zhvillim,
Edukim dhe Etikë Ekologjike – POLIMAT
13

Titulli i projektit: Eko libër lojçak me figura

Qëllimi i projektit: Rritja e vetëdijes tek
fëmijët dhe të rinjtë për rëndësinë e mjedisit
të pastër jetësor.

Rezultate të arritura:

- Rritje e njohurive dhe shprehje të
përmirësuar tek fëmijët dhe të rinjtë
nga komuna e Bogdancit për mjedis të
pastër jetësor.
- Rritje të aktiviteteve ekologjike në
kopshtet dhe shkollat fillore në komunën
e Bogdancit dhe Entit për rehabilitim për
fëmijë me të dëgjuarit e dëmtuar Koço
Racin nga Manastiri.
- Rritja e vetëdijes tek personeli arsimo –
edukativ dhe drejtues i kopshteve dhe
shkollave fillore në komunën e Bogdancit
mbi rëndësinë e aktiviteteve ekologjike
në procesin arsimor.




Trajnime dhe takime në internet të organizuara nga RZR përgjatë vitit 2020

Përshtatja ndaj situatës që lindi me pandeminë, Rrjeti për Zhvillim Rural i Maqedonisë së Veriut, gjatë vitit 2020 organizoi shumë trajnime dhe takime në internet me organizatat anëtare. U organizua trajnim online për Monitorimin dhe Vlerësimin e Projektit me qëllim të përmirësimit të kapaciteteve të organizatave të mbështetura në kuadër të projektit për mbështetjen institucionale të RZR të MV. Për të ndihmuar organizatat anëtare për të rritur aftësitë e tyre të përfaqësimit dhe lobimit, RZR organizoi trajnim në internet për përgatitjen e përmbledhjeve të politikave.

Duke respektuar masat e parandalimit, 15 përfaqësues të anëtarëve të RZR të Maqedonisë së Veriut, u mbledhën në Vila Marija, në Demir Kapia, për t'u pajisur me njohuri në menaxhimin financiar dhe në atë mënyrë të forcojnë kapacitetet e organizatave të tyre lokale.

Anëtarët e grupit tematik të RZR mbi Barazinë Gjinore, mbajtën një takim në internet për të diskutuar ndikimin e pandemisë tek gratë në rrethinat rurale. Kjo ishte një mundësi për anëtarët për të ndarë informacione dhe përvoja të ndryshme nga puna në zonat rurale, si dhe për të identifikuar problemet kryesore dhe sfidat me të cilat përballen gratë rurale gjatë pandemisë.



Rrethi i Studimit të Mjedisit

Në fillim të shkurtit 2020, nxënës të shkollave të mesme nga rrethina e Radovishit, të ndihmuar nga OJQ lokale "KRUNA PLUS", filluan një Rreth Studimi mbi mjedisin. Një vullnetar i Korpusit të Paqes me një njohuri të gjerë në fushën e mjedisit dhe ndryshimit të klimës u zgjodh të ishte një udhëheqës i Rrethit të Studimit, ndërsa roli bashkë-udhëheqës rrotullohej mes anëtarëve të tjerë të grupit. Pesëmbëdhjetë anëtarë të Rrethit të Studimit u takuan në bibliotekën e shkollës së mesme për 6 seanca gjatë shkurtit dhe marsit. Katër seancat e fundit u mbajtën në internet për shkak të shpërthimit të koronavirusit dhe masave paraprake të ndërmarra në vend. Anëtarët e rinj të Rrethit të Studimit mësuuan dhe diskutuan në shumë tema, përfshirë ekosistemet; mbeturina të ngurta; ndotja e ujit dhe ajrit dhe ndryshimi i klimës. Ata ndanë problemet mjedisore që kanë në nivelin lokal, duke diskutuar në lidhje me shkaqet kryesore të ndotjes, si ata mund të mbrojnë mjedisin e tyre dhe cilat lloje të riciklimit të mbeturinave mund të praktikojnë në nivelin lokal. Në një seancë,

ata vizituan deponinë e qytetit në Radovish për t'u njohur me mënyrat e ndryshme të hedhjes së mbeturinave dhe për të mësuar nëse mbeturinat shtëpiake, posaçërisht mbeturinat e ngurta (plastika) po riciklohen. Për t'u njohur me mënyrën si funksionojnë dhe operojnë sistemet e trajtimit të ujërave të ndotura, mënyrat e trajtimit të ujërave të ndotura, si pastrohen dhe si ndikon e gjitha në jetën e egër dhe në të gjithë rrjetin e ekosistemit, anëtarët e Rrethit të Studimit vizituan impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura në Radovish. Të etur për të mësuar më shumë rreth ndotjes së ajrit, në një nga sesionet, anëtarët e Rrethit të Studimit ftuan një ekspert të mjedisit dhe së bashku argumentuan për ndotësit kryesorë të ajrit në vend.

Në sesionin e fundit, të 10-të, anëtarët e Rrethit të Studimit të Mjedisit diskutuan rreth hapave të mëtejshëm dhe mundësive për përfshirjen e tyre në aktivitetet e zbatuara nga OJQ "KRUNA PLUS". Pas përmbushjes së pritjeve të tyre, anëtarët e këtij grupi ishin shumë të interesuar që të marrin pjesë më tej në trajnimet për kompostim në kopshte dhe shkolla fillore në komunën e Radovishit, si dhe në hartimin e librave për ngjyrosje, materialeve video dhe njoftimeve për kompostim në lidhje me mjedisin.



Sigurimi me ushqim dhe përforcimi ekonomik i komuniteteve më të cenuar në Maqedoninë e Veriut



Si përgjigje e pasojave të cilat dalin nga pandemia me virusin korona, organizata suedeze për zhvillim We Effect, bashkë me partnerët në Maqedoninë e Veriut, Rrjetin për Zhvillim Rural, Federatën Kombëtare të Fermerëve dhe Qendra Kombëtare e Romëve, kanë marrë aktivitete për mbështetjen e personave më tepër të goditur nga kjo pandemi. Me anë të projektit që do të zbatohet në territorin e gjithë vendit, ofrohen zgjidhje për uljen e ndikimit të krizës në lidhje me sigurimin e ushqimit dhe përforcimit të kapaciteteve të komuniteteve më të cenuar në vend. Projekti, që është financuar dhe zhvilluar në bashkëpunim të ngushtë me Ambasadën e Suedisë në Maqedoninë e Veriut, jo vetëm që parashikon intervenim urgjent, por do të kontribuojë për vetë-qëndrueshmërinë dhe ngopjen e gjitha këtyre komuniteteve të goditjeve të ngjashme në të ardhmen.

“Pandemia Kovid-19 ka ndikim të madh mbi shumicën e njerëzve në botë, veçanërisht mbi grupet më të cenuar të cilat kanë mundësi të kufizuar të krijojnë jetë të denjë për veten dhe për familjet e tyre. Ende është herët për të vlerësuar pasojat e plota të pandemisë, por do të ketë nevojë për ndërmarrjen e masave të shumta për të ulur efektet. Suedia shume vite bashkëpunon me We Effect në Maqedoninë e Veriut dhe mendojmë që kjo iniciativë është përgjigje e mirë për zbutjen e pasojave nga pandemia, lidhur me sigurimin e ushqimit dhe përforcimin ekonomik të kategorive më të cenuar të njerëzve në Maqedoninë e Veriut, posaçërisht ata të cilat jetojnë në zonat rurale. Në fushën e zhvillimit, Suedia mbetet partner i njerëzve nga Maqedonia e Veriut”, deklaroi Kristin Forsgren Bengston, ambasadore e Mbretërisë së Suedisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Viset rurale në Maqedoninë e Veriut janë shtëpi e 40 përqind të popullatës së plotë të vend, dhe dy të tretën e të varfërve. Me krizën e krijuar si rezultat i pandemisë, shumë familje nga zonat rurale përballohen me probleme të ekzistencës, bizneset e vogla kanë vështirësi në punën, ndërsa njerëzit që ekzistojnë në margjinat, gjithë e më tepër varfërohen. Problemet më të mëdha të fermerëve janë zinxhirët e prishura të furnizimit dhe mungesa e punëtorëve sezonal.

Situata është veçanërisht e vështirë nëse shikohet nga prizma e jetës së përditshme të popullatës romë që një pjesë e madhe ekziston nga ekonomia gri, duke shitur rroba ose duke mbledhur letër ose plastikë të vjetër – burime të cilat për momentin janë shumë të kufizuara.

“Duke parë më qartë pasojat e pandemisë, që kanë ndikuar mbi ekzistencën e komuniteteve më të cenuar në Maqedoninë e Veriut, kuptuam që me rëndësi të madhe është të ndërmarrim aktivitete konkrete. Shpresoj që ky projekt do të sjell ndryshime pozitive dhe do të sigurojë një ardhmëri të sigurt për fermerët, posaçërisht për gratë dhe të rinjtë nga zonat rurale, si dhe për komunitetin e marginalizuar të romëve”, deklaroi Aneli Leina, drejtore rajonale e organizatës Suedeze për Zhvillim We Effect.

Rrjeti për Zhvillim Rural i Maqedonisë së Veriut si folës dhe përfaqësues aktiv i nevojave të popullatës rurale në vend, vetëm më ka identifikuar problemet dhe sfidat në zonat rurale, të krijuara si pasojë e pandemisë. “Në veçanti gëzohem që ky projekt do të mundësojë, jo vetëm në mënyrë të drejtë të përballojmë, por edhe të ofrojmë zgjidhje inovative dhe afatgjate për përfundimin ekonomik të zonave rurale dhe sigurimin me ushqim të popullatës së cenuar dhe të marginalizuar”, theksoi Petar Gjorgievski, kryetar i Rrjetit për Zhvillim

Rural i Maqedonisë së Veriut.

Sipas analizës së FKF për bujqësinë dhe krizën me koronën, të mbështetur nga We Effect, ky sektor do të përballohet me panjohuri të rritur, papunësi të rritur, qasje të kufizuara në fuqi punëtore sezonale, prishte të zinxhirëve të sigurimit dhe qasjes në ushqim dhe mungesa e masave të drejta për mbështetje të fermerëve të vegjël dhe fermerëve për përballim me varfërinë. “Këto probleme në fermerët e ndjejmë dhe nuk kemi fuqi për të përballuar me ato. Me anë të këtij projekti presim që të bëhen intervenime për uljen e prishjeve të zinxhirit të sigurimit të ushqimit në përputhje me nevojat dhe sfidat e fermerëve, posaçërisht për gratë dhe të rinjtë dhe për baraspeshim të ofertës dhe kërkesës në vend”, theksoi Vaska Mojsavska, kryetare e Federatës Kombëtare të Fermerëve.

Katerina Shojiq, drejtuese e projektit të Qendrës Kombëtare Romë (NRC) theksoi që në periudhën e pandemisë së Kovid-19, NRC përmbush mirë misionin për të shërbyer romëve si bartës të drejtave dhe të përgjigjet sfidave të krijuara. “Shpresojmë që niveli i lartë i mos përfshirjes së romëve në punë do të zgjidhet do të do të arrihet përparim në përfshirjen dhe aftësimin e të rinjve rom dhe romë në gjenerimin e të ardhurave. NRC synon për dukshmëri të efekteve të aktiviteteve të projekteve në fushat e përfundimit ekonomik të grave dhe të rinjve rom, zhvillimi i ndërmarrjeve sociale të udhëhequra nga femrat romë, mbrojtja e të drejtave në relacion pune, mbrojtja nga dhuna e bazuar në gjini të grave dhe vajzave romë, duke krijuar një bazë të fuqishme për shërbimin nga gjendja aktuale në të cilën gjenden dhe përballohen romët”, thotë Shojiq.

Projekti “Sigurimi me ushqim dhe përfundimi ekonomik në Maqedoninë e Veriut” ka për qëllim të përforcojë kapacitetin e



komuniteteve rurale dhe të marginalizuar në vend me atë që do të sigurojë përgjigje të shpejtë dhe efikas ndaj dëmeve të shkaktuara ekonomike nga pandemia dhe do të hap rrugën një zhvillimi të përshtatshëm, përfshirës dhe të qëndrueshëm.

Në këtë drejtim, projekti punon në promovimin e sistemeve të vetëqëndrueshme për sigurim me ushqim, të cilat do të jenë të

ndjeshme gjinore dhe të gatshme për gjithë. Me anë të themelimit dhe prezantimit të lidhjeve alternative të tregut për fermerët, krijimin e qendrave për ushqim dhe sigurim të perspektivave ekonomike për popullatën e cenuar që përfshin edhe gratë, të rinjtë dhe komunitetin rom, ofrohen zgjidhje të cilat do të përmirësojnë jetën dhe do të mbrojnë kategorinë më të cenuar të njerëzve në këtë moment dhe në të ardhmen.

Strategjitë e Zhvillimit Lokal të Rishikuara

Zbatimi i aktiviteteve të qasjes LEADER në Maqedoninë e V. ka filluar një dekadë më parë përmes mbështetjes nga donatorë, fonde dhe projekte të ndryshme (BE, USAID, GIZ, mbështetje teknike e vendeve të ndryshme, etj.).

Rolin kryesor në lidhje me aktivitetet e qasjes LEADER ka Rrjeti i Zhvillimit Rural të Maqedonisë së Veriut që mbështet formimin e grupeve të zhvillimit rural me shumë aktorë, të zyrtarizuar më vonë si Grupe Lokale të Aksionit dhe duke siguruar mbështetje në përgatitjen e Strategjive të Zhvillimit Lokal, SZL, dhe duke punuar në mënyrë aktive në ndërtimin e kapaciteteve dhe implementimin e SZL.

Me mbështetjen e ofruar nga RZR të MV, Strategjitë e Zhvillimit Lokal të 4 GLA-ve (Malesh-Pijanec, GLA Belasica Ograzhden, GLA Bojmija dhe GLA Plachkovica) u zhvilluan për periudhën 2016-2020. Ndonëse strategjitë kanë një gamë të gjerë të nevojave që adresohen pasi që analiza përfshiu një numër të madh të palëve të interesuara të komunitetit lokal, shumë pak nga aktivitetet e parashikuara ishin zbatuar në të kaluarën për shkak të mungesës së fondeve nga qeveria qendrore dhe lokale për të financuar LEADER masën dhe zbatojnë strategjitë e zhvillimit lokal. Gjithashtu nga këndvështrimi i sotëm nëse shikojmë gamën e aktiviteteve të planifikuara në strategji mund të konkludojmë se shumë aktivitete nuk janë realisht të realizueshme në përputhje me shpejtësinë e proceseve të zhvillimit në territoret e GLA-së. Për më tepër, në periudhën e kaluar, situata në zonat rurale ka pësuar ndryshime veçanërisht për



shkak të migrimit të madh të të rinjve nga zonat rurale në territorin e 4 GLA-ve që shtrihen në rajonin lindor dhe jug-lindor të vendit.

Nga ana tjetër, situata me qasjen LEADER si një masë qeveritare për zhvillimin rural ka bërë një përparim pozitiv si mes Programit Kombëtar të Zhvillimit Rural ashtu edhe mes IPARD në mënyrë që nga viti 2019, GLA-të e regjistruara të marrin fonde mes Programit Kombëtar të Zhvillimit Rural ndërsa përpjekjet po bëhen për të përdorur fonde për LEADER përmes masës së Ndihmës Teknike IPARD.

Duke marrë parasysh faktin se strategjitë ishin në vitin e fundit të zbatimit, por edhe për arsyet e përshkruara më lart, u konkludua se ato duhet të rishikohen në mënyrë që të përshtaten me zhvillimet e reja dhe nevojat në zonat rurale. Për ta bërë këtë, USAID ofroi ndihmë financiare për Rrjetin e Zhvillimit Rural të Maqedonisë së Veriut për të organizuar punëtori të nivelit rajonal dhe aktivitete të ndërgjegjësimit për rritjen e mundësisë së financimit nga BE për çështje të lidhura me bujqësinë dhe për të rishikuar strategjitë e 4 GLA-ve. SZL-të e rishikuara morën parasysh proceset e reja të zhvillimit dhe përfshinë të gjithë aktorët lokalë me ndikim, si dhe ata që mund të ndikojnë në zhvillimin e zonës në të ardhmen.

Garë për storie gazetareske

Si pjesë e projektit të financuar nga Bashkimi Evropian "NAGE – Rrjetëzimi dhe përfaqësimi për ekonomi të gjelbër" (Networking and advocacy for green economy) që zbatohet nga 7 organizata partnere nga Ballkani, Rrjeti për Zhvillim Rural i Maqedonisë së Veriut ka publikuar thirrje për garë për gazetarë dhe media për hulumtim dhe promovim të ekonomive më të mira të gjelbra ose praktika afariste rurale ekologjike të sigurta.

Deri në afatin e parashikuar (3 dhjetor 2020), në thirrjen për garë janë përgjigjur shtatë gazetarë me gjashtë storie gazetareske, gjatë së cilës ishin përfshirë tema lidhur me bujqësinë, kompostimin, riciklimin, produkte inovative si zëvendësimi i plastikës, etj.

Gjatë procesit të vlerësimit cilësor, Komisioni i përbërë nga dy gazetarë dhe një ekspert i ekonomisë së gjelbër, i kanë vlerësuar produktet e arritura gazetareske sipas kriterëve më poshtë:

- Metodologjia e hulumtimit (koncept i arsyetuar hulumtues, gjegjësisht temë, burime nga të cilat janë mbledhur të dhënat, veglat gazetareske të përdorur gjatë punës)
- Stili i të shkruarit gazetaresk
- Rëndësia e temës
- Respektimi i standardeve gazetareske dhe etike (prania e fakteve, saktësia dhe besueshmëria e pohimeve).



Pas notimit të bërë për secilën storie dhe përmbledhë të pikëve nga secili vlerësues, ekipi i projektit të RZR të MV konkludoi që "Nga letra e ricikluar në ambalazh për vezë" të gazetares Aleksandra Maksimovska është zgjedhur për storie më e mirë.

Gazetarja e stories së parë fitoi çmim në shumë bruto prej 1.500 (njëmijë e pesdëqind) euro.

Qëllimi i fundit të kësaj storie është të motivojë gazetarë dhe media tjerë, si dhe të nxit krijimin e storieve tjera gazetareske që do të kontribuojnë për rritjen e vetëdijes publike për rëndësinë e ekonomisë së gjelbër dhe sipërmarrjen e gjelbër.

Storien mund të lexoni në lidhjen më poshtë.

Një vizion për Evropë Rurale

Shfrytëzimi i potencialit të zonave rurale për të kontribuar në një Evropë të qëndrueshme dhe të prosperuar

Konventa Bujqësore dhe Rurale, ARC2020 mobilizoi një panel me organizatat e shoqërisë civile dhe lëvizjet rurale, të cilët prezantuan një diskutim të hapur me qytetarët që marrin pjesë përmes video konferencës, pasuar nga një shkëmbim mendimesh mes kryetarëve të Komiteteve për Bujqësi dhe Mjedis të Parlamentit Evropian.

Kjo ngjarje e përgjithshme "Një vizion për Evropën rurale - Shfrytëzimi i potencialit të zonave rurale për të kontribuar në një Evropë të qëndrueshme dhe të prosperuar" u organizua nga Presidenti i Grupit të Evropës së Rinovuar, Dacian Ciolos dhe u mbajt më 7 korrik, 14.30 - 17.00 CET.

Petar Gjorgievski, gjithashtu ishte përfshirë në këtë diskutim për të ndarë mendimet e OJQ-ve që punojnë në zhvillimin rural në Ballkanin Perëndimor, nën ombrellën e Rrjetit Ballkanik për Zhvillim Rural. Ai ka treguar për potencialet e zonave rurale të Ballkanit Perëndimor, zbrazëtirës ekzistues midis zonave rurale dhe urbane, si dhe nevojat për të investuar në zhvillimin e zonave rurale.

"Procesi i zhvillimit rural të Ballkanit Perëndimor është një nga proceset kryesore nxitëse që me të vërtetë mund të përshpejtojë procesin e pranimi në Ballkanin Perëndimor në BE. Megjithatë, për të arritur këtë duhet të investojmë në forcimin e besimit të ndërsjellë në çdo nivel, mes njerëzve, institucioneve, në nivelin kombëtar, por gjithashtu



ekziston një nevojë e madhe për investime për forcimin e besimit midis Ballkanit Perëndimor dhe Bashkimit Evropian dhe për të ndërtuar partneritet të rëndësishëm të barabartë. Sigurisht që jemi të vetëdijshëm se disa Ballkani Perëndimor e ka këtë imazh negativ nga e kaluara, por një perceptim i tillë i mosbesimit të vazhdueshëm krijon një bllokim në proceset e integritit në BE dhe gjithashtu ndikon negativisht në zhvillimin e zonave rurale. Pra, ne duam të ndryshojmë këtë perceptim në një perceptim pozitiv që Ballkani Perëndimor ka vlera specifike që na afrojnë më shumë sesa na ndajnë, dhe këto vlera mund të pasurojnë vetëm vlerat e BE." tha Petar Gjorgievski në drejtimin e tij.

https://re.livecasts.eu/a-vision-for-rural-europe?fbclid=IwAR3H-jsxCQThi8yD2e8To2mPIBkjGAmhRWslx2ygs-uz6uZkNCKM_V7g-GM

Zhvillimi rural me anë të Aerodromit Sportiv

Aeroklubi Shkupi ekziston prej vitit 1923 në vende të caktuara të rrethinës së Shkupit. Nga viti 1984 aerodromi gjendet në vendin Glluvo, Stenkovec. Me ndarjen e vetëqeverisjes lokale në vitin 1996, aerodromi në mënyrë administrative kalon në komunën e re Çußer Sandevë.

Komuna Çußer Sandevë është komunë rurale që shtrihet në fillim të Skopska Crna Gora, në veri të Shkupit. Ajo përfshin sipërfaqe prej 235 km² dhe ka 8.493 banorë. Në komunë, si degë më e zhvilluar ekonomie është bujqësia, pastaj miniera Banjani, si dhe disa kompani tjera të vogla private.

Zhvillimi i kësaj komune është lidhur bashkërisht me zhvillimin e Aeroportit Sportiv Stenkovec. Për një çerek shekulli komuna punon me Aeroklubin në drejtim të përmirësimit të kushteve dhe cilësisë së jetës së banorëve të kësaj komune.

Vizioni i Aeroklubit është krijimi i një aeroporti sportiv ku dashamirët e aviacionit do të mund të vijnë dhe të merren me sportet ajrore dhe të kënaqen në këtë lloj të aktiviteteve. Për të plotësuar këtë lloj të vizionit duhet që aeroporti Stenkovec të zhvillohet si një destinacion bashkëkohor me përmbajtje interesante. Përmbajtjet janë në dispozicion jo vetëm për sportistët profesional, por edhe ato vendor dhe turistët.

Pozita e Aeroportit Sportiv Stenkovec është ajo që mund të ofrojë turistëve dhe vizitorëve një pamje ajrore të qytetit të Shkupit, kanjonit Matka, Vodno, Skopska Crna Gora, Akuaduktin Romak, qytetit antik Skupi, etj. Me nisje nga Stenkoveci e gjithë Maqedonia është në dorë.



Prandaj, në vitin 2020, Aeroklubi, me mbështetjen e BE, Bankës Botërore dhe Ministrisë së Ekonomisë së RMV, në kuadër të projektit "Projekti për Konkurrencë Lokale dhe Rajonale", ka ndërtuar një objekt turistik, një restorant me kapacitet prej 300 personave dhe një kapacitet të vogël akomodimi prej 6 dhomave. Ishin krijuar kushte atraktive për turistët, si për shembull, kërcime tandem me parashutë, provë për fluturim të fluturësave, provë për fluturim të avionëve sportiv, provë për fluturim të avionëve ultra të lehtë, tandem fluturime me paraglajder, fluturim me avion të komanduar me radio dhe drone, etj.

Disa prej planet e Aeroklubit për zhvillim të mëtejshëm janë: Muze i aviacionit, ndërtimi i hangarëve për avionë/garazheve për avionë, autokamp, ndërtim të serës



për kultivimin e druve dhe rinovim të infrastrukturës (rrugë, parkim, shenja informative).

Muzeu është paramenduar si një kompleks bashkëkohor virtual në të cilën vizitorët do të mund me anë të prezantimeve audio vizuale të njoftohen me historinë. Një pjesë e kompleksit janë simulatorë të fluturimit, parashutizimit dhe drejtimi me modele të avionëve. Qëllimi është që përveç njohurive të historisë, fëmijët e moshës shkollore të përfitojnë edhe një pjesë praktike të shkencave natyrore, posaçërisht nga fusha e aerodinamikës.

Meqë qarkorja e qytetit të Shkupit kalon afërt aeroportit, plani është të bëhet një autokamp që të mund udhëtarët të pushojnë gjatë udhëtimit të tyre.

Parashikohet edhe një vend i posaçëm në të cilin do të mbillen dru tipik për këtë rajon dhe do të mbillen rreth aeroportit dhe në komunën. Ideja është që secili anëtar i ri të mbjell drurin "personal" në aeroport dhe të kujdeset për atë. Teprica e druve do të dhurohen palëve të interesuara.

Aeroklubi rregullisht zbaton edhe projekte të ngjashme të cilat i mbështetin, jo vetëm aviacioni, por edhe vlerat themelore demokratike dhe njerëzore. Aeroklubi punon me persona me aftësi të kufizuara në pjesët ku mund të merren me sportet ajrore dhe pjesët e mbrojtjes së mjedisit jetësor me anë të zhvillimit të projekteve për pyllëzim ajror.

Aeroklubi Shkup ka një ekip të trajnuar dhe kapacitet për udhëheqje me projekte dhe janë të hapur për bashkëpunim me institucione dhe organizata qytetare të cilat punojnë në drejtim të zhvillimit të kësaj komune rurale. Këtë zhvillim, Aeroklubi e shikon nëpërmjet rritje të atraksioneve në komunë dhe rritjes së numrit të turistëve, me çfarë pa dyshim do të rritet numri i vendeve të punës, dhe me atë drejtpërdrejtë pengohet migracioni i të rinjve nga komuna.





ZËRI I LUMIT TË BARDHË

Kolonia Artistike 2020

Në periudhën prej 25 shtator deri më 5 tetor, me mbështetjen e pjesshme të Ministrisë së Kulturës, në qendrën ndërkombëtare për art dhe zhvillim të qëndrueshëm ishte zhvilluar kolonia artistike me titull "Zëri i Lumit të Bardhë".

Dijana Tomiq – Radevska, Sasho Sazdovski, Pandora Apostolloska Sazdovska, Filip Velkovski, Goran Ristovski dhe Keti Talevska janë artistët e parë maqedonas që në mënyrë zyrtare kanë marrë pjesë në gumno artistike në Slloeshticë. Në karantinë të plotë artistike, artistët kanë krijuar të inspiruar nga tema "Zëri i Lumit të Bardhë" në fakt, në kushte të izolimit, për shkak të pandemisë globale, natyra padyshim që filloi të vije në rend të parë dhe të imponohet. Në mungesë të zhurmës që zakonisht e krijojmë ne, njerëzit, të ngutur pas materiales, zërat që dëgjojmë nga natyra sikur të ftojnë të zhytemi më thellë në veten. Atëherë, hapen çështjet e thelbit të qenies, për lidhjen tonë me natyrën, për artin si mundësi, që në mënyrë lokale madje edhe globale të flasim për këtë lidhje, për ujërat e lidhura dhe në këtë mënyrë të lidhin gjithë botën, dhe veçanërisht GJITHË artistët e botës.

Ekskluzive e këtij edicioni i kolonisë artistike ishte nënshkrimi i KARTËS për vëllazërim, që pas 15 vite bashkëpunim, "Art Point – Gumno" dhe kolumna artistike "De Niro" nga Capari zyrtarisht i kanë kryqëzuar brushat.



Projekt IPA i BE:

ZBULIMI I ATRAKSIONEVE TË FSHEHURA

Falë interesit më të madh të publikuesve të huaj, FOTOGRAFIA për Slloeshticë, fotografia për viset dhe njerëzit, për natyrën dhe pasuritë shpirtërore, me anë të fjalës së Petre M. Andreevski, ka filluar rrugën për në botë. Por, duke filluar nga dhjetori i vitit 2019, falë edhe projektit **Zbulimi i Atraksioneve të Fshehura**, ajo do të bëhet pjesë e vlerave të përbashkëta evropiane.

Me këtë projekt, bartës i të cilës është komuna Demir Hisar, ndërsa "Art Point – Gumno" nga Slloeshtica, si dhe komuna Killoso dhe organizata joqeveritare FLAG, nga



R. e Shqipërisë, të cilët janë partnerë lokal, në fund realizohen përpjekjet shumë vjeçare për vendosjen e një përkujtimi memorial për bordin e letërsisë maqedonase në kuadër të shtëpisë së rindërtuar të bashkuar.

Ajo që është një dobi për këtë projekt, kryesisht, është mbështetja nga popullata lokale në drejtim të përforsimit të kapaciteteve për veprimtari plotësuese të orientuar drejt turizmit rural. Ajo do të thotë që FSHATARËT E FUNDIT të rajonit të Demir Hisarit, pikërisht ata që janë inspirim të përhershëm dhe të pashterur të Petre, do të jenë të motivuar të qëndrojnë këtu në fshatrat e tyre dhe të ndajnë historitë e tyre për atraksionet e fshehura me turistët vendor dhe të huaj. Me ndihmën e ekspertëve maqedonas dhe shqiptar për turizëm, në shtator, në vend dhe në Shqipëri ishin organizuar punëtori paralele për dhënësit potencial të shërbimeve turistike. Temat ishin:

- "Ndarja e atraksioneve nga rajonet ndërkufitare me turistët – përfitimet për bashkësitë lokale në Klos dhe Demir Hisar" dhe
- "Marketing dhe promocion për turizëm të qëndrueshëm rural".

Paralelisht me përforsimin e kapaciteteve të popullatës lokale dhe promovim të atraksioneve të fshehura të rajonit, në Slloeshticë, që vetëm më duket një edicion i a.q."Bella Kuka" (kooperativa e vjetër fshatare).

www.artpoint-gumno.org.mk



Tradita dhe artizanet e vjetra si pasuri e madhe kombëtare



Shoqata e artizanëve artistik “ARTI KRAFT” ishte përballuar me sfida të shumta në zbatimin e aktiviteteve gjatë shpërthimit të pandemisë. Më të vështirë ishin përpjekjet për të afruar artizanet personave të rinj, qytetarët e rëndomtë si dhe institucionet e sistemit. Një sfidë e madhe ishte realizimi i komunikimit mes artizanëve dhe institucionet e sistemit, si dhe tentime për promovim të vlerave tradicionale, kulturore dhe të zakonshme me anë të lidhjes së kombësive që veprojnë dhe jetojnë në këto hapësira.

1. Me rastin e 8 shtatorit, Ditës së Pavarësisë Maqedonase, më 7 shtator 2020, në Shkup, në periudhën prej 9-18, në hapësirat e QTQ, ARTI KRAFT ka organizuar një BAZAR në të cilat janë prezantuar veprat e artizanëve vendor dhe artizanëve të vjetër, artistë, talente të ri, të cilët me anë të krijimeve të tyre e prezantojnë artin dhe kulturën maqedonase në një vend.

2. Më 15 tetor 2020, para ndërtesës administrative të komunës së Butelit, ishte shënuar “Dita Ndërkombëtare e Gruas Rurale”, me ekspozitë të produkteve të prodhuar me dorë nga ana e anëtareve të ZUR “ARTI KRAFT” – Shkup. Në kuadër të ngjarjes, gratë nga rrethinat rurale kanë

kërkuar edukim shëndetësor dhe qasje më të mirë në shërbimet shëndetësore gjatë kohës së KOVID19. Si problem të veçantë kanë theksuar varshmërinë ekonomike nga gratë, pamundësinë të merren me të ardhurat nga veprimtaria bujqësore, mos posedimi i pronës, etj. Ata treguan interes të lartë për aftësim profesional dhe kualifikim të mëtutjeshëm për prodhimin e ushqimit të shëndetshëm ekologjik kur edhe shohin ardhmërinë. Gjithashtu, mbrojtja e mjedisit jetësor ishte një prej temave më prioritare.

Oferta nga shoqata ARTI KRAFT për ndihmë të përpunimit të kujtimeve me vegla origjinale gjithashtu ka zgjuar interes të madh.

3. Me rastin e 11 nëntorit, çlirimi i qytetit të Kumanovës, ARTI KRAFT ka zhvilluar dy ngjarje.

- Defile mode me shall të bardhëm nga studio e modës “ETNO BEBA” nga Kumanova,
- Zgjedhje e Kujtimit më të mirë nga komuna e Kumanovës për vitin 2020.

4. Në mënyrë tradicionale, edhe këtë vit, ARTI KRAFT ka marrë pjesë aktive në pjesëmarrjen e bazarit të vitit të ri në Qendrën Tregtare të Qytetit në Shkup ku ishin ekspozuar produktet e shoqatës.



Oferta e integruar dhe informative e territorit të GLA Bojmija

Rajonin mikro që e përfshijnë komunat e Bogdanci, Vallandovë, Gjevgjeli dhe Dojran, të bashkuar me Grupin Lokal të Aksionit "Bojmija" kanë hapur perspektiva të reja dhe mundësi për bashkëpunim në pjesën e brendimit të produkteve dhe shërbimeve lokale që është parakusht për njohjen më të mirë të GLA-së.

Me realizimin e një pjese të aktiviteteve të parashikuar në projektin "Oferta e integruar dhe informative e territorit të GLA Bojmija" në secilën prej katër komunave ishin vendosur tabela informative të cilat do të promovojnë GLA-në Bojmija dhe do të rrisin informimin e gjerë dhe turistik të vizitorëve. Tabelat e informimit ishin vendosur në vendet më shpeshta të katër komunave që e formojnë territorin e GLA Bojmija. Ato shërbejnë për informim dhe promovim të partneritetit mes këtyre komunave në nivelin mikro-rajonar dhe vlerat evropiane të pranura me zbatimin e qasjes LEADER.

Me anë të aplikacionit android dhe QR kodi i të cilës ishte vendosur në tabelat informative do të rritet informimi i gjerë dhe turistik për mikro-rajonin që përfshin GLA Bojmija dhe do të mundësojë një pasqyrë të shpejtë dhe efikas për mundësitë potenciale të zhvillimit të turizmit në rajone të ndryshme të GLA-së.

Realizimi i takimeve në internet, informimi me anë të rrjeteve sociale dhe materialit të shtypur ka shkaktuar interesim tek banorët lokal në mikro-rajonin që të njihen më afër me termat Grupi Lokal i Aksionit, LEADER, strategjia lokale për zhvillim e bazuar



në territor. Në këtë mënyrë kanë fituar informacione, si dhe mundësi edhe vetë të marrin më tepër pjesëmarrje në vetë procesin, të jenë edhe pjesë e procesit të zbatimit të Strategjisë, dhe të marrin pjesë në ndërtimin dhe zgjerimin.

Qëllimi i këtij projekti është mundësimi i shqyrtimit të shpejtë dhe efikas të mundësive potenciale të rajoneve të ndryshme të GLA territorit.

Projekti "Oferta e integruar dhe informative e territorit të GLA Bojmija" realizohet nga grupi lokal i aksionit Bojmija, dhe financiarisht mbështetet nga Agjencia për Mbështetjen Financiare të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe komunat e territorit të GLA-ve.



Zgjidh shëndetshëm – bli produkte lokale

Prodhimtaria e ushqimit dhe cilësisë së produkteve të rrethinës së Gjevgjelisë – Vallandovës është e njohur për gjithë dashamirët e ushqimit. Me dekada më herët ky rajon ishte i njohur me produktet e hershme kopshtare, për domatet e shijshme, pemët dhe perimet. Numri i ditëve me diell, klima mesdhetare, qasja në ujë, sipërfaqet përpunuese dhe pozita e mirë ishte arsye përse vizitorët ishin të mahnitur nga cilësia dhe shija e produkteve. Me kalimin e kohës, interesi i konsumatorëve për cilësinë e ushqimit, origjina dhe mënyra e prodhimit filloi të rritet. Përveç kësaj, rritja e vetëdijes së popullatës për përfitimet e mënyrës së shëndetshme të ushqimit ka kontribuar që të rritet kërkesa e produkteve nga prodhues i njohur, dhe ata janë gjithnjë më të paktë në tregun. Gjithashtu, si rezultat i krizës ekonomike të shkaktuar nga pandemia, ishte paraqitur një nevojë për planifikim më të hollësishëm të blerjes

së produkteve të ndryshme, përfshirë edhe vendosja e rendit të produkteve, prodhuesit, vendit dhe periudha e prokurimit të produkteve.

Projekti “Zgjidh shëndetshëm – bli produkte lokale” ka ofruar zgjidhje të mundshme të këtij problemi, me anë të themelimit të një zinxhiri të shkurtë të furnizimit me ushqim, gjegjësisht të njohura me terminologjinë në gjuhën angleze si “Short Food Supply Chain” ose “Short Food Chain Systems”. Ato janë sisteme të organizuara të cilat mundësojnë konsumatorëve të blejnë ushqimin drejtpërdrejtë (pa, ose me numrin më të vogël të ndërmjetësuesve) në mënyrë sistematike, të organizuar dhe të qëndrueshëm. Kjo mënyrë mundëson shitjen e produkteve drejt nga fermat, shitoret në pronësi të fermerëve, nga klubet, kooperativat, shitje në internet dhe mënyra tjera. Veçori e përbashkët është që konsumatorët në mënyrë të drejtë lidhen me prodhuesit e ushqimit gjatë blerjes së produkteve të tyre.

Për këtë qëllim ishte krijuar një platformë e bazuar në internet për shitjen e produkteve lokale bujqësore që mund të gjendet në <https://kupuvajlokalno.mk/>.

Qëllimi i përgjithshëm i projektit ishte të krijohen kushte për rritjen e të ardhurave të fermerëve të vegjël me anë të tërheqjes së fermerëve të rinj me anë të prezantimit të inovacioneve në bujqësi dhe zhvillim rural. Grupe të synimit janë prodhues të ushqimit nga rajoni i Gjevgjeli, si dhe konsumatorët që kanë interes të blejnë ushqim nga prodhues lokale, të cilëve prioritet e kanë mënyrën e prodhimit dhe cilësinë.

Platforma e bazuar në internet ka kontribuar që një pjesë e madhe e prodhuesve të pranojnë pikërisht mënyrën e shitjes në internet dhe promovim të produkteve si zgjidhje për sigurimin e të ardhurave. Nga ana tjetër, konsumatorëve ju ofrohet siguri dhe cilësi në ushqimin.

Vendosja në funksion të platformës në internet <https://kpuvajokalno.mk/> ka nxitur prodhuesit e vegjël të publikojnë

produktet dhe të shesin në internet.

Për promovim më të madh të projektit është përgatitur material promovues, si dhe video reklamë që transmetohet në televizionin rajonal dhe ka për qëllim tërheqjen e konsumatorëve lokal. Përveç reklamës, ishte përpunuar edhe një video e shkurtë me të cilën promovohet gjithë projekti, donatorët dhe përfitimet nga projekti, si dhe Studim për Përcaktimin e Rrezeve Kryesore dhe zgjidhje të mundshme të ofruara për arritjen e qëndrueshmërisë së sistemit.

Projekti "Zgjidh shëndetshëm – bli produkte lokale" që zbatohet nga Fondacioni për Zhvillim Lokal dhe Zhvillim të Teknologjive Informatike – (FLORIT) Gjevgjeli, mbështetjet nga Rrjeti për Zhvillim Rural i Maqedonisë së Veriut, me anë të projektit për zhvillimin e kapacitetit të Rrjetit të financuar nga "We Effect".

SHQ CeProSARD në organizimin për shënimin e Ditës Ndërkombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuar

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuar më 4 dhjetor këtë vit ishte organizuar një ngjarje informative në të cilin ishte prezantuar projekti "Bashkë për më tepër mundësi dhe mbështetje" – TIMOR, që zbatohet nga shoqata e qytetarëve CeProSARD. Ishte organizuar edhe një tryezë e rrumbullakët me pjesëmarrjen e aktorëve që punojnë në fushën.

PROJEKT: ЗАЕДНО ЗА ПОВЕКЕ МОЖНОСТИ И ПОДДРШКА

Овој проект е финансиран од Европското Унија

Проектот е реализиран од:

CEPROSARD, ССЕР, ЛОЗА ФАУНДЕЈШН

ГЛОБАЛНАТА ЦЕЛ НА ПРОЕКТOT „TIMOR“ Е:

ПРЕСЕКА НА ЛИЦАТА СО ПОТРЕБНОСТ КОИ ЖИВЕАТ ВО ИНСТИТУЦИИ

- ИНСТИТУЦИИТЕ СЕ МЕСТА КАДЕ ЖИВЕАТ ЛИЦА СО ИНТЕЛЕКТУАЛНА ПОТРЕБНОСТ СО ДРУГИ ЛИЦА СО ИНТЕЛЕКТУАЛНА ПОТРЕБНОСТ
- ТИЕ ЖИВЕАТ ОДВОЈНО СО ДРУГИТЕ ЛИЦА
- ОБА Е ОНА ШТОТО НАРЕКУВАМЕ „СЕРТИФИКАЦИЈА“

ПОСЛЕДОВАТЕЛНОСТ НА ЦЕЛИТЕ НА ПРОЕКТOT „TIMOR“:

- ЛИЦАТА СО ПОТРЕБНОСТИ МОЖАТ ИСТО ТАКА:
- ДА КОМУНИКАТ СО КОТО И КАДЕ ДА ЖИВЕАТ
- ДА СЛУЖАТ КАКО СЛУЖАТ ДА ПОГОДИМАТ СВОЕТО ВРЕМЕ
- ДА ИМААТ ИСТИНСКАТА КАРТО И СВОЕ ДРУШО ЛИЦЕ
- ДА ДОБИЈАТ ПОДДРШКА КОЈА ИМА Е ПОТРЕБНА ПОВОДО ЗА ВРЕМЕНА НА СЛОБОДНА РАБОТА НА ПОДРШКА И КОМУНИКАЦИОНА НАМЕНИ

Qëllimi kryesor i projektit TIMOR është ndihma e personave me aftësi të kufizuar të dalin nga institucionet, të jetojnë vetë në bashkësitë dhe të kenë mbështetje për të bërë atë që dëshirojnë. Ata do të mund të zgjedhin me kë do të jetojnë dhe të kalojnë kohën e tyre, të kenë përvoja të njëjta si dhe persona tjerë, të marrin mbështetjen kur kanë nevojë për ndihmë për të kryer punët e ndërlikuar në mënyra të ndryshme dhe të ndërlikuara.

Grupe të synimit dhe përdoruesit e fundit:



- Persona me aftësi të kufizuar dhe familjet e tyre
- Njësitë e vetëqeverisjes lokale - NJVL
- Institucionet relevante shtetërore
- Organizatat qytetare (OJQ) të cilat punojnë në fushat sociale

Aplikuesi kryesor:

- SHQ Qendra për Promovim të Praktikave të Qëndrueshme Bujqësore dhe Zhvillim Rural - CeProSARD

Bashkë-aplikantë:

- EP Enti Special Demir Kapia
- Komuna Demir Kapia



- Lidhja e edukatorëve special dhe rehabilitues e Republikës së Maqedonisë së Veriut
- Fondacioni Loza, Suedi

Institucione të përfshirë:

- Ministria e Punës dhe Politikës Sociale

Kohëzgjatja e projektit:

2 janar 2020 – 1 janar 2023.

Ngjarja informative në të cilën është promovuar projekti TIMOR dhe projektet tjera që punojnë në de-institucionalizimin ishte organizuar nga MPPS dhe mbështetur financiarisht nga 4 projektet të cilat punojnë në de-institucionalizim. Ngjarjen mund të shikoni në lidhjen vijuese: <https://www.youtube.com/video/o0b-dCptlqY/livestreaming>

Programi për trajnim të shërbimit të turistëve

Projekti "Nxitja e turizmit rural dhe ekologjik me anë të qendrave të mençura informative turistike/FRETSTIC" për zhvillim dhe promovim të turizmit lokal dhe rajonal të Maqedonisë dhe Kosovës, me anë të qasjeve inovative dhe sisteme për përmirësimin e përvojës rurale dhe ekologjike, qëllimin e arrin me anë të krijimit të veglave strategjike të cilat do të mundësojnë kuptimin më të mirë të kërkesave të vizitorëve. Këto vegla shërbejnë edhe si mekanizma për bashkëpunim të përforcuar rajonal me anë të aspektet e ndryshme të industrisë, institucionet qeveritare, sektori afarist dhe organizatat qytetare që do të rezultojë me rritjen e potencialit turistik, të përshtatur me nevojat e grupeve të synimit.

Përveç kësaj, projekti ka për qëllim krijimin e rrethinës së volitshme për arritje strategjike dhe fitim jo vetëm nga tregjet kombëtare dhe rajonale, por edhe nga tregjet

ndërkombëtare të industrisë turistike.

Si pjesë e aktiviteteve të këtij projekti, prej 26.10.2020 deri më 30.10.2020 ishte realizuar pjesa e dytë e trajnimit me anë të platformës ZOOM, synuar për pjesëmarrësit që do të përdorin veglat e krijuara.

Programi dhe orari i trajnimit është pjesë e trajnimit me temën "Trajnimi për psikologji të konsumatorëve dhe marketing në mediat sociale".

Partnerë të projektit janë:

- Qendra për Promovim të Praktikave të Qëndrueshme Bujqësore dhe Zhvillim Rural – CeProSARD si organizatë udhëheqëse;
- Komuna e Tetovës;
- Regional Development Agency South, Kosovë

Donator: Bashkimi Evropian


Teknologji referuese për efikasitet energjetik dhe burime të ripërtërirë të energjisë me vlerësim të konsumit energjetik të spitaleve dhe punëtori në temën “Spitale me energji afër zeros”

CeProSARD në tremujorin e fundit të vitit në kuadër të projektit Spitale me energji afër zeros ka hartuar një “Studim për teknologji referuese për efikasitet energjetik dhe burime të ripërtërirë të energjisë” si dhe “Vlerësim të konsumit energjetik të spitaleve sipas prototipave modulare të ndërtesave”. Rezultatet e studimit mund të zbatohen edhe për ndërsa tjera me veçori të ngjashme ose të përdoren gjatë dizajnit të spitaleve të reja dhe ato do të jepen për përdorim institucioneve përkatëse. Qëllimi kryesor është të jepet kontribut për përmirësim të efikasitetit energjetik të sektorit ndërtimor dhe më konkretisht efikasiteti energjetik të ndërtesave të spitaleve të cilat janë më shumë të ndërlikuara.

Më 18.12.2020 në kuadër të këtij projekti ishte zhvilluar një punëtori, në të cilën në mënyrë të hollësishme ishin prezantuar mundësitë për drejtim me energjinë në spitale, përdorimi i efikasitetit energjetik dhe burimeve të ripërtërirë të energjisë gjatë rindërtimit të spitaleve dhe rezultatet e analizave krahasuese të ndërtesave me konsum energjetik më afër zeros. Në punëtorinë ishte prezantuar edhe metoda LCCA (Life Cycle Cost Analysis) që përdoret për vlerësim ekonomik të intervenimeve në ndërtesa me prokurime publike të vendeve të BE-së.

Në bazë të zbulimeve të analizave të bëra në kuadër të projektit dhe kontroleve energjetike të spitaleve, do të përgatitet një manual dhe rekomandime për përdorimin e teknologjive të ndryshme që duhet të përmirësojnë efikasitetin energjetik të spitaleve që të jenë spitale me konsum energjetik afër zeros.

Donator i projektit është INTERREG Ballkan Mediteran 2014-2020 Fondi Evropian për Zhvillim Rajonal.



Viti 2020 – 14 vite nga ekzistimi i Qendrës Rajonale për Përfaqësim – Dellçevë



1. Për herë të parë këtë vit, Qendra Rajonale për Përfaqësim – Dellçevë, në mënyrë aktive ishte kyçur në fushat më aktuale të periudhës, ajo është lufta kundër lajmeve falso dhe dezinformatave. Me anë të dy projekteve për arsimim mediatik dhe digjital, ka përforcuar kapacitetet e nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme në këtë fushë dhe për herë të parë ka organizuar fushatë publike për ngritjen e vetëdijes së qytetarëve duke shënuar javën kombëtare për arsimi mediatik në Dellçevë. Një prej produkteve kryesore të këtij procesi tetë mujor është aplikacioni celular DIGILIT që është synuar për nxënësit e shkollës së mesme të qytetit. Në këtë aplikacion gjendet lista e lidhjeve të kontrolluara dhe të sakta në internet të cilat nxënësit bashkë me profesorët e krijuar për secilën lëndë, dhe mund të përdoren si material plotësues.

2. Në kuadër të mjedisit jetësor, si fushë strategjike e veprimit të QRP-Dellçevë, organizata ka avancuar kapacitetet e rreth 100 përfaqësuesve të sektorit qytetar, komunave dhe mediave në Dellçevë, Berovë, Pehçevë dhe Makedonska Kamenicë, lidhur me Konventën e Arhusit, si dokument më i rëndësishëm i miratuar në këtë fushë. Grupet synuese i kanë përforcuar njohuritë e tyre në pjesën e qasjes së lirë në informacione, qasje më të mirë në drejtësi dhe përfshirje të publikut në miratimin e vendimeve që në fakt janë dhe tre shtyllat kryesore të kësaj konvente. Ishte përpiluar edhe një video promovuese dhe ishte organizuar një debat në TV me ekspertë të kësaj fushe.



3. Me mbështetjen e projektit të BE-së, "Rrjetëzimi dhe Përfaqësimi për Ekonomi të Gjelbër", zbatuar nga rrjetet për zhvillim rural në Ballkanin Perëndimor, QRP ka realizuar projektin "Lidhja rajonale dhe zbatimi i përbashkët i konceptit të ekonomisë të gjelbër", që përfitues të drejtpërdrejtë ishin përfaqësues të sektorit të biznesit nga mikro-rajoni Malesh-Pijanec. Në periudhë prej gjashtë muajve ishin organizuar dy trajnime për ekonomi të gjelbër për sektorin e biznesit dhe atë qytetar, dhe për një prej kompanive të pranishme ishte hartuar një plan trevjetor për plan të veprimit të gjelbër nga ana e një eksperti të fushës. Në kuadër të fushatës së vogël që ishte organizuar, ishte krijuar një video prej dy minutave, që si tjerat, përmbajtjet multimediale të krijuar në kuadër të projektit, ishte vendosur në ueb faqen zyrtare të QRP dhe rrjetet sociale.

4. Në kuadër të financimit vjetor të organizatave qytetare nga ana e komunës së Dellçevës, QRP ka hartuar strategjinë e re për Zhvillimin Ekonomik Lokal të komunës për periudhën 2021-2025.

5. Vitin 2020 QRP ka përmbyllur me fillim të projektit nga fusha e sipërmarrjes sociale. Në fokusin e kësaj fusha janë të rinjtë nga Dellçeva të cilëve do të përforcohen shkathtësitë e udhëheqjes dhe sipërmarrjes, ndërsa aktiviteti kryesor do të jetë hapja e HUB-it të parë rinor në qytet në gjysmën e parë të vitit 2021. Ky HUB do të jetë vendi kur të gjithë të rinjtë mund të vijnë dhe të përforcojnë shkathtësitë e tyre në procesin e krijimit të planeve për biznes të cilat më vonë do të prezantojnë para sektorit të rajonit.



Koalicioni Rural

Koalicioni Rural vitin 2020 ka shënuar me përforcimin e vetëdijes së opinionit më të gjerë, të institucioneve por edhe bashkësisë lokale për nevojën e përfshirjes sociale dhe ekonomike të grave nga zonat rurale.



Pas paraqitjes së pandemisë me Kovid-19, shoqata e qytetarëve Koalicioni Rural ka investuar shumë, në fillim në përhapjen e informacioneve lidhur me virusin dhe mbrojtjen nga virusi. Në kohën e njëjtë, gjatë vizitave në teren, ishte shprehur një mesazh i qartë që barazia gjinore është e drejta themelore e njeriut që është pjesë e Kapitullit 23 – Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore të Njeriut, që është si një temë horizontale kalon në gjitha kapitujt tjera të procesit të negociatave për aderim në Bashkimin Evropian. Koalicioni Rural ka vizituar mbi 100 gra të fshatrave të Maqedonisë së Veriut, duke përfshirë pesë rajonet e planifikimit – verilindor, të Pellagonisë, të Pollogut, jugperëndimor dhe juglindor, me qëllim të rritjes së informimit të grave nga zonat rurale për barazinë gjinore si e drejtë themelore e njeriut. Përveç kësaj, për shkak të pandemisë, vizitat në teren ishin përdorur edhe për rritje të vetëdijes për mbrojtje nga virusi. Projekti ishte financuar nga Fondacioni Shoqëri e Hapur Maqedoni.

Në kuadër të projektit “Barazia gjinore – çelësi për bashkësi rurale të fuqishme ekonomike”, Koalicioni Rural ka punuar në analizën e masës 115 për mbështetje të një anëtarit aktiv femër të ekonomisë bujqësore gjatë së cilës ka përgatitur një dokument të shkurtër për politika publike që ishte dhënë edhe në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujit gjatë takimit me zëvendës ministrin e bujqësisë, z. Trajan Dimkovski. Anëtarët e Lobit Rural të Grave që funksionon si trup joformal në kuadër të Koalicionit kanë pasur mundësin që para zëvendës ministrit të shprehin gjitha rekomandimet që dalin



nga procesi i aplikimit të masës 15, dhe në drejtim të përmirësimit dhe avancimit të vetë masës që të mund të jetë e gatshme për përdorim nga ana e numrit më të madh të grave nga zonat rurale. Për thirrjen e parë kanë aplikuar gjithsej 400 gra, por mbi 53% të grave nga rajoni i planifikimit verilindor dhe të Pollogut nuk kanë pasur aspak informacione që kjo masë ka ekzistuar, andaj dy palët kanë marrë për detyrë që të punojnë më tepër drejt në teren në periudhën para dhe pas publikimit të masës gjatë vitit të ardhshëm. Gjithashtu, Koalicioni Rural këto qëndrime dhe rekomandime i ka prezantuar edhe para grupit të punës për barazi gjinore dhe përforsimit ekonomik që është pjesë e



Ministrit së Bujqësisë, dhe punën e të cilëve e mbështet UN Women. Një prej qëllimeve kryesore të këtij grupi është pikërisht mbështetja dhe përfshirja e grave në procesin e krijimit të masave dhe politikave në përputhje me nevojat e grave të zonave rurale. Në takimin e fundit të punës që ishte mbajtur më 14 tetor 2020 ishte pranishëm edhe ministri Arijanit Hoxha, gjatë së cilës në kuadër të grupit, ishte shënuar edhe Dita Ndërkombëtare e Gruas Rurale – 15 tetori.

Powered by:

MAAA
MACEDONIAN AMERICAN ALUMNI ASSOCIATION

U.S. Embassy Skopje

UNLOCKING RURAL WOMEN ENTREPRENEURSHIP POTENTIAL >>>

Anjali Chandran
Founder, Impresia Kozhikode
IVLP Alumna

Dr. Blagica Sekovska
Department of Rural Economy, FVM - Skopje

Marina Tosheska
IVLP Alumna


Liljana Jonoski
Executive Director of CSO Rural Coalition

10.12.2020 10:30 zoom

Më 17 tetor, Koalicioni Rural ishte prezantuar edhe në Ditën e Organizatave Qytetare në parkun Shkolka në Shkup, në të cilën mbi 120 organizata i kanë prezantuar aktivitetet e tyre para qytetarëve. Koalicioni ka prezantuar prodhimtarinë lokale të ushqimit, mënyrën e kultivimit të produkteve bujqësore, dhe me qëllim të përforcimit të qytetarëve të blihet prodhimi lokal dhe në këtë mënyrë të mbështeten edhe prodhuesit bujqësor dhe ekonominë vendore në kohën e krizës së shkaktuar nga pandemia Covid.

Më 10 dhjetor, ishte zhvilluar një panel diskutim në temën **njohja e potencialit të sipërmarrjes së grave në zonat rurale në të cilën kanë diskutuar aktivistët qytetar, ekspertë të fushës**, si dhe sipërmarrësja sociale nga India Anjali Chandran, që në fakt është edhe themeluese e një prej ndërmarrjeve më të suksesshme sociale në nivel global. Tema e bisedës ishte hapat e nevojshme që duhet të merren për të liruar potencialin për sipërmarrje të grave në zonat rurale. Barazia gjinore si dhe vendimi me

pjesëmarrje, por edhe dalja nga ekonomia joformale janë pjesë e perspektivave që DUHET patjetër të arrihen për të fituar biznese të qëndrueshme të udhëhequr nga gra në mjediset rurale. Ajo që është e barabartë dhe kryesore është: informimi me kohë, përfshirja e grave në gjitha qelizat e shoqërisë, por edhe zhvillimi i shërbimeve të veçanta të përshtatura për nevojat e grave si shërbime këshillimore, engjëj afaristë, qendra rajonale për kujdesin e fëmijëve, etj. Diskutimi në panel edhe njëherë ka theksuar rëndësinë dhe rolin e gruas nga zona rurale si bartëse e ndryshimeve transformuese ekonomike, sociale dhe të jetës në bashkësinë lokale. Panel diskutimi





ishte organizuar si e parë në këtë formë në të cilën më konkretisht do të shqyrtohen zgjidhjet për dalje nga kriza me kovid me mbështetjen e grave të zonave rurale. Ngjarja ishte mbështetur dhe vijuar nga Ambasada e SHBA në Republikën e Maqedonisë së Veriut si dhe Asociacioni i Alumni në RMV.

Në fund të vitit 2020, Koalicioni Rural ka shënuar me një fushatë për mbështetje të ushqimit të prodhuar lokal "pako të ndryshme për vitin e ri të ndryshëm" në të cilën në fokus ishin ekonomitë e vogla familjare bujqësore dhe ishin mbledhur rreth 250 pako me ushqim të prodhuar organik. Një pjesë e pakove ishte dorëzuar në bashkëpunim me organizatat joqeveritare fëmijëve me një prindër, si pjesë e fëmijëve të sëmurë nga kovid, dhe një për çerdhen Olga Miceska nga Kërcova, ku fëmijët e vegjël për herë të parë kishin mundësi të shohin një pako pak të ndryshme nga ajo e rëndomtë, por edhe të mësojnë më tepër për prodhimtarinë e pemëve dhe perimeve në vendin tonë. Kjo fushatë ishte mbështetur nga ana e programit Civica Mobilitas.



The background of the page is a solid light green color. Overlaid on this are several large, abstract, organic shapes in various shades of green and yellow. These shapes resemble stylized leaves or petals, some pointing towards the center and others extending outwards. The shapes are layered, creating a sense of depth. In the bottom right corner, there is a prominent, thick, yellow-green swirl that loops upwards and to the left.

This material is completely or partly financed by the Swedish International Development Cooperation Agency (Sida) and We Effect. Sida and We Effect does not necessarily agree with the opinions expressed.